



Republika e Kosovës	Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit	Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution
Nr/Prishtina:	KPD/933/2024
Dati/Date:	27/10/2024
PRISHTINE-PRISTINA PRISTINA	



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

në lidhje me gjendjen e lumbit dhe të hapësirave rreth tij në lagjen në "Kalabria" në Prishtinë

R. nr. 683/2024

Lumturije Gjoshi

Drejtuar: Z. Përparim Rama, kryetar
Komuna e Prishtinës

Prishtinë, më 21 tetor 2024

Qëllimi i Raportit

Ky Raport me Rekomandim ka për qëllim që t'ia tërheqë vëmendjen Komunës së Prishtinës përkitazi me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve të menjëherershme për pastrimin e lumit në lagjen “Kalabria” në Prishtinë dhe hapësirave rrëth tij, me qëllim të përbushjes së të drejtave të qytetarëve të lagjes, për gëzimin e një mjetit të pastër, të sigurt dhe të shëndetshëm.

Ky Raport është i bazuar në informata që kemi pranuar nga ankuesja, nga dalja e përfaqësuesve të IAP-së në vendin e ngjarjes dhe nga të dhënat dhe rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës pas inspektimit të vendit të ngjarjes.

Baza Ligjore e Avokatit të Popullit

Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, ndër të tjera, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- “Për t'i hetuar ankesat e pranuara nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me Kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.” (neni 16, paragrafi 1).
- “Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tillë dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tillë.” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2).

Veprimet e Avokatit të Popullit

- Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 18 korrik 2024 ka pranuar ankesën e znj. Lumturije Gjoshit, parashtruar kundër Komunës së Prishtinës për mospërgjigje dhe mosveprim ndaj kërkesave të saj për pastrimin e hapësirave dhe shtratit të lumit/përroskës përgjatë rrugës “Rexhep Krasniqi” në lagjen “Kalabria” në Prishtinë.
- Sipas pohimeve të ankueses dhe dokumentacionit që është dorëzuar në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP), znj. Gjoshi më 19 maj dhe 20 maj, si dhe më 24 qershor 2024, nëpërmjet adresës elektrike dhe shkresës fizike i është drejtuar Komunës së Prishtinë me kërkësë emergjente për pastrimin e shtratit të lumit përgjatë rrugës “Rexhep Krasniqi” në lagjen “Kalabria” në Prishtinë. Kërkesat ishin parashtruar për shkak të gjendjes së rëndë të lumit dhe hapësirave përreth nga ndotja me ujëra të zeza, sasive të mëdha të mbeturinave, përfshirë ato inerte, kundërmimin dhe paraqitjen e vazhdueshme të brejtësve dhe insekteve. Sipas ankueses, nga tejmbushja e shtratit me mbeturina pengohet rrjedha natyrore e ujit dhe nga gjendja e krijuar, si pasojë, në kohë reshjesh atmosferike shkaktohen vërvshime, duke depërtuar në pronat e banorëve përreth. Edhe pse banorët janë në dijeni për projektin e Komunës për ndërtimin e kolektorit, situata e krijuar mjetisore kërkon veprime të menjëherershme, pasi përbën rrezik për shëndetin e banorëve dhe se kërkesa e tyre për pastrimin e lumit, deratizimin dhe dezinfektim është më se e nevojshme për parandalimin e cenimit të shëndetit të banorëve nga ndotja e mjetisit, njëherësh edhe masë parandaluese për vërvshime, për dëme materiale dhe pronësore të

qytetarëve. Ankuesja ka pohuar se deri në kohën e parashtrimit të ankesës në Institucionin e Avokatit të Popullit nuk ka marrë përgjigje nga Komuna e Prishtinës në kërkesat e saj.

3. Më 19 korrik 2024, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit e kanë vizituara vendin e ngjarjes dhe kanë vërejtur se ndotja me mbeturina e lumbrit dhe e hapësirave përreth tij, si dhe gjendja e mjedisit në përgjithësi, ishin shqetësuese për shëndetin dhe jetën e qytetarëve. Gjendjen e përkeqësonte në veçanti kundërmimi i liruar nga rrjedha e lumbrit, si dhe lënia e mbetjeve të drurëve të prerë në shtratin e lumbrit dhe përreth tij.
4. Më 22 korrik 2024, Avokati i Popullit, duke u bazuar në rrethanat e rastit si dhe në të gjeturat nga vizita e realizuar në vendin e ngjarjes, i është drejtuar me kërkesë Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), që në bazë të kompetencave të përcaktuara me Ligjin nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike, ta inspektoonte gjendjen e lumbrit përgjatë rrugës “Rexhep Krasniqi” në lagjen “Kalabria” në Prishtinë.
5. Më 25 korrik 2024, Avokati i Popullit ka marrë përgjigje nga IKShPK-ja, e cila nëpërmjet raportit nga inspektimi i vendit të ngjarjes ka evidentuar të gjeturat si në vijim: “*Gjatë inspektimit në këtë lagje, konkretisht të rrjedhjës ujore-prrocka, ekipi vërejti se prrocka shërben si deponi e mbeturinave të ngurta (orendi shtëpiake, trupa të drunjëve të prerë, barishte etj) dhe të lëngëta, ku edhe vërehen gypa shkarkues të ujërave të zeza të cilat derdhen në këtë rrjedhje ujore. Nga kjo prrockë kundërmron erë shumë e fortë dhe e rendë.*

Në bisedë me banorët e lagjes, ankesa kryesore e tyre është kundërmimi i pa durueshëm nga kjo rrjedhje ujore, e cila ju shkakton shqetësim shëndetësor dhe janë të detyruar të kërkojnë ndihmë mjekësore. Për arsyet e hedhjes së mbeturinave të ngurta në rrjedhje ujore pas çdo reshje shtëpitë në këtë lagje vërshohen. Gjithashtu banorët ankohen për prezencën e insekteve (miza, mushkonja etj.) si dhe brejtëseve.

Për të gjitha këto shqetësime banorët u janë drejtuar institucioneve relevante (Komunës së Prishtinës, Inspektoratit Komunal, Departamenti për Shërbime Publike etj.) mirëpo nuk kanë marr asnjë përgjigje dhe nuk është vërejtur asnjë veprim, përpos para një javë kur janë prerë drunjët rreth prrockës dhe të njëjtat janë lënë në vendin e prerjes. Këto mbetje të drunjave të prerë pengojnë rrjedhjen e ujit.

Bazuar ne vlerësimin e inspektimit si dhe deklaratat e banoreve kushtet për jetesë ne këtë lagje janë të vështirësuara dhe ka rrezikshmëri për shëndetin e banorëve.”

6. Për më tepër, IKShPK-ja në raportin në fjalë i ka përbledhur të gjeturat dhe rekomandimet adresuar strukturave relevante, si në vijim:

“Gjatë inspektimit në terren vërehet se:

- *Në prrockë ka shkarkim të ujërave të ndotura, mbeturina të ngurta dhe barishta të ndryshme që përveç që kundërmjnë erë të keqe edhe favorizojnë shumimin e mikroorganizmave, parazitëve, brejtësve dhe insekteve;*
- *Situata epidemiologjike për momentin në këtë lagje është e qetë, përkundër rasteve individuale me ankesa te kohëpaskohshme, por gjithsesi ekziston rrezik permanent për shfaqjen e ndonjë sëmundjeje infektive dhe rrjedhimisht rrezik për shëndetin e qytetarëve në këtë zonë.*

Rekomandime:

Me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të banorëve të kësaj zone dhe sanimin e kësaj situate rekomandojmë strukturat relevante:

- *Urgjentisht të bëjnë hulumtimin dhe eliminimin e derdhjeve të mundshme të ujërave të zeza dhe ndotësve të tjerë potencial;*
- *Inspektorët komunal të mjedisit dhe ata sanitare të marrin masa konkrete për zbulimin dhe zgjidhjen e këtij problemi;*
- *Deri në zgjidhjen përfundimtare, prrocka që kalon në lagje, të mirëmbahet rregullisht nga strukturat relevante dhe nga vete banorët (largimi i mbeturinave dhe barnishtave si dhe të ndalohet hedhja e mbeturinave në prrocke).*

IKSHPK konsideron që zbatimi i këtyre masave është i domosdoshëm për tekalimin e problemit aktual dhe rrjedhimisht mbrojtjen e shëndetit të popullatës.”

Ligjet e aplikueshme në rastin konkret

7. Vlerësimet dhe konstatimet e Avokatit të Popullit, përkitazi me rastin R.nr.683/2024, bazohen në të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e zbatueshme në vend, me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNj) dhe me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj).
8. Kushtetuta, mbrojtjen e mjedisit jetësor, përveçqë e garanton në Kapitullin e të Drejtave dhe Lirive Themelore, e rendit në mesin e vlerave të rendit kushtetues, ku në nenin 7 [Vlerat] përcaktohet si në vijim: “*1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet..., respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit [...].*”
9. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përgjegjësinë përmes një specifikon: “*Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin.*”
10. GjEDNj-ja, nëpërmjet praktikës gjyqësore të saj, ka konstatuar se mbrojtja e mjedisit trajtohet në frymën e KEDNj-së, në nenin 2 [E drejta për jetën] dhe në nenin 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare].
11. KEDNj-ja në nenin 13 përcakton të drejtën përmes zgjidhje efektive: “*Cdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përbushje të funksioneve të tyre zyrtare.*”
12. E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare përcaktohet me nenin 8 të KEDNj-së: “*Cdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe [...].*”
13. Ligji nr.03/L-025 përmes Mbrojtjen e Mjedisit, në nenin 1, paragrafi 2, përcakton: “*Qëllimi i këtij ligji është të promovojë krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës me sjelljen graduale të standardeve përmes një Bashkimit Evropian.*” Kurse nenin 2, paragrafi 2, përcakton: “*Ky ligj synon [...] përmirësimin e kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut [...] bashkërendimin e veprimtarive shtetërore përmes përbushur kërkësat përmes mbrojtjen e mjedisit [...].*”

14. Ligji nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës shprehimisht në nenin 1 përcakton se resurset ujore janë pasuri me interes të përgjithshëm dhe pronë e Republikës së Kosovës, që ruhen e mbrohen me ligj. Referuar nenit 1, paragrafëve 2.1 dhe 2.3, qëllimi i këtij ligji, përvèç të tjerash, është të sigurojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin social-ekonomik të Republikës së Kosovës dhe të sigurojë mbrojtjen e resurseve ujore nga ndotja, tej shfrytëzimi dhe keqpërdorimi.
15. Ligji për Ujërat e Kosovës, në nenin 46, saktëson se komuna është kompetente për mbrojtje nga vërshimet, nga veprimet e dëmshme të ujërave, për mbrojtjen nga erozioni dhe nga veprimet e tjera të dëmshme në zona urbane, në zona të kufijve të qytetit.
16. Ligji nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja ka për qëllim të përcaktojë kompetencat dhe përgjegjësitë e institucioneve për të siguruar të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një mjesht me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjeshtit nga ndotja e ajrit.
17. Ligji nr.02/L-78 për Shëndetësinë Publike, në nenin 6, paragrafi 6.1, përcakton: "*Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHP) hulumton ndikimin e faktorëve mjeshtor në shëndetin e popullsisë dhe i propozon masat mbrojtëse për parandalimin e efekteve të dëmshme për shëndet*" kurse paragrafi 6.2 përcakton: "*IKSHPK propozon dhe ndërmerr veprime profesionale dhe u rekomandon institucioneve kompetente eliminimin e mangësive të zbuluara dhe çfarëdo efekti të dëmshëm për shëndet*."
18. Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 17, përcakton: "*Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standarde përcaktuare në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijojnë:*
- [...]
- e) *mbrojtjen e mjeshtit lokal,*
- f) *ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshire [...] trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave [...]*
- i) *promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut[...]*
- m) *shëndetësinë publike; [...].*"
19. Referuar nenit 98 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (më tej referuar si LPPA), lidhur me afatin përfundimin e procedurës administrative, përcaktohet: "*1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuari me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj. 3. Nëse me ligj parashihet detyrimi i palës për të parashtruar një dokument apo për të kryer një veprim procedural, si pjesë apo së bashku me parashtrimin e kërkesës përfundimin e procedurës, afati i përcaktuari në pajtim me paragrafin 1 ose 2 të këtij neni, do të fillojë të llogaritet nga parashtrimi i dokumentit apo kryerja e veprimit procedural përkatës.*"

Analiza ligjore dhe konstatimet e Avokatit të Popullit

20. Një ndër parimet e së drejtës ndërkombëtare mjedisore është arritja e një zhvillimi të qëndrueshëm që u mundëson qytetarëve cilësi të lartë jetese në një mjedis të pastër, të sigurt dhe të shëndetshëm.
21. Në rastin konkret, bazuar në ankesën e palës, fakteve që Avokati i Popullit i posedon, dhe Raportit të IKShPK-së, ndotja e lumit/përroskës dhe hapësirave përgjatë rrugës “Rexhep Krasniqi”, në lagjen “Kalabria” në Prishtinë, lagje e banuar nga qytetarët, janë tregues të mjaftueshëm dhe mund të vlerësohet se qytetarëve u pamundëson jetë cilësore dhe gjëzimin e qetë të shtëpisë.
22. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit, duke u bazuar në gjendjen në terren, e në veçanti në Raportin e IKShPK-së, sipas të cilit: “*Ekziston rrezik permanent për shfaqjen e ndonjë sëmundjeje infektive dhe rrjedhimisht rrezik për shëndetin e qytetarëve në këtë zonë.*”, vlerëson se gjendja e krijuar e mjedisit nga ndotja e lumit, duke e pamundësuar një jetë kualitative të banorëve, përbën rrezik për shëndetin e tyre.
23. Avokati i Popullit, edhe pse në dijeni për projektin e Komunës për ndërtimin e kolektorit, implementimi i të cilit është tej zgjatur, konstaton se niveli i lartë i ndotjes dhe mundësia e ndikimit të rëndë në të drejtat e njeriut dhe në shëndetin e banorëve kërkon veprime të menjëherëshme nga autoritetet përgjegjëse për pastrimin e lumit, deratizimin dhe dezinsektimin e hapësirave.
24. Sipas Avokatit të Popullit, gjendja në lagjen në fjalë kërkon ndërhyrje urgjente të autoriteteve kompetente për sanimin e gjendjes, si dhe parandalimin e kufizimit të së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, të së drejtës së privatësisë dhe të familjes dhe të mundësisë serioze të cenimit të shëndetit të banorëve nga ndotja.
25. Bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNj), autoritetet publike janë të detyruara të ndërmarrin masa konkrete për të siguruar që të drejtat e njeriut të mos preken seriozisht nga faktorë të dëmshëm mjedorë. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në nenin 8, paragrafi 1, përcakton: “*Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës, [...].*”
26. GjEDNj-ja¹ ka vlerësuar se ndotja e mjedisit mund të ndikojë në mirëqenien e individëve dhe të parandalojë gjëzimin e shtëpisë, në mënyrë të tillë, duke ndikuar negativisht në jetën private dhe familjare dhe se shteti duhet t'i përbushë detyrimet pozitive për t'uua respektuar jetën e tyre private dhe familjare (nenin 8 i Konventës).
27. GjEDNj-ja², në rastin e ndikimit të ndotjes së mjedisit jetësor në problemet kronike shëndetësore të banorëve, kishte theksuar se ndotja mund të ndikojë negativisht në shëndetin publik në përgjithësi dhe përkeqëson cilësinë e jetës së një individi, edhe pse shpesh është e pamundur të përcaktohet efekti i saj në secilin rast individual. Gjykata më tej kishte theksuar se të jetosh në një zonë me tejkalime të qarta të standardeve të lejuara të ndotjes, përbën rrezik të lartë për shëndetin. Në këtë rast GjEDNj-ja gjeti shkelje të nenit 8, pasi autoritetet nuk kishin gjetur një zgjidhje efektive për situatën në mënyrën për ta frenuar ndotjen.

¹ Guerra dhe të tjerët kundër Italisë.

² Dubetska dhe të tjerët kundër Ukrainës.

28. Avokati i Popullit në këtë çështje u bën ftesë autoriteteteve për ndërmarrjen e masave parandaluese, duke pasur parasysh pastrimin e rrjedhës së shtratit nga mbeturinat, si masë parandaluese nga vërshimet dhe depërtimi i ujërave në periudha me reshje, në pronat e banorëve përreth.
29. Avokati i Popullit sjell në vëmendje se Objktivi 6.3 i Agjendës 2030 shprehimisht potencon përmirësimin e cilësisë së ujit duke përgjysmuar përqindjen e sasisë së ujërave të zeza: “*6.3 Deri në vitin 2030, të përmirësohet cilësia e ujit duke zvogëluar ndotjen, duke eliminuar hedhjen e mbetjeve jashtë vendit të përcaktuar dhe duke minimizuar shkarkimin e kimikateve dhe të materialeve të tjera të rrezikshme, duke përgjysmuar përqindjen e sasisë së ujërave të zeza të patrajuara dhe duke rritur ndjeshëm riciklimin dhe ripërdorimin e sigurt në nivel global.*”
30. Avokati i Popullit konsideron se në rastin konkret është obligim ligjor dhe ekskluziv i organeve të komunës së Prishtinës dhe asnjë plan për implementimin e projekteve, që sipas monitorimit të Avokatit të Popullit është tej zgjatur, nuk e arsyeton dhe nuk mund ta lirojë nga përgjegjësia për mosndërmarrjen e masave të menjëherëshme për pastrimin dhe sanimin e burimeve të ndotjes, të cilat paraqesin rrezik për shëndetin e banorëve, si dhe njëherësh mund të shkaktojnë vërvësime dhe dëme materiale në pronat e banorëve.
31. Avokati i Popullit, në rastin konkret, bazuar në të gjeturat e paraqitura në këtë Raport me Rekomandime, si dhe analizimit të standardeve ligjore vendore dhe ndërkontekstuale, përfshirë praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, konstaton se jetesa e qytetarëve në një mjedis me nivele të larta të ndotjes përbën cenim të së drejtës së qytetarëve për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm dhe cenim të jetës private dhe familjare.
32. Po ashtu Avokati i Popullit gjen se Komuna e Prishtinës, duke mos u përgjigjur në kërkesën e znj. Gjoshit, nuk ka arritur t'i respektonte pritshmëritë e saj legitime përkundër obligimit ligjor të dalë nga neni 98 i Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, lidhur me afatin përfundimin e procedurës administrative, sipas së cilit: “*1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përgjithshëm i zbatueshëm përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i sa ...”*

Avokati i Popullit, duke theksuar domosdoshmërinë e përbushjes së obligimeve pozitive të shtetit për ndërmarrjen e masave konkrete për sanimin e gjendjes në hapësirat përgjatë rrugës “Rexhep Krasniqi” në lagjen “Kalabria” në Prishtinë, dhe po ashtu duke e sjellë në vëmendje: “*IKShPK-ja në raportin e vet konsideron se zbatimi i këtyre masave është i domosdoshëm për tejkalinin e problemit aktual dhe rrjedhimisht mbrojtjen e shëndetit të popullatës.*”, bazuar në nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili përcakton: “[...] ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”, dhe në pajtim me nenin 18, paragrafi 1.2, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, i

REKOMANDON

Komunës së Prishtinës:

- *Në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore, t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme me efekt të menjëherëshëm për pastrimin e lumbit dhe të hapësirave rrëth tij, në lagjen "Kalabria" në Prishtinë.*
- *Të veprojë në pajtim me rekondimmet e IKShPK-së, si në vijim:*
 - *"Urgjentisht të bëjnë hulumtimin dhe eliminimin e derdhjeve të mundshme të ujërave të zeza dhe ndotësve të tjera potencial;*
 - *Inspektorët komunal të mjesdit dhe ata sanitare të marrin masa konkrete për zbulimin dhe zgjidhjen e këtij problemi;*
 - *Deri në zgjidhjen përfundimtare, prrocka që kalon në lagje, të mirëmbahet rregullisht nga strukturat relevante dhe nga vete banorët (largimi i mbeturinave dhe barnishtave si dhe të ndalohet hedhja e mbeturinave në prrocke)."*
- *Të informohet ankuesja për veprimet e ndërmarra nga organet komunale në drejtim të zgjidhjes së problematikës së ngritur.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkeseve të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj.") dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekondim, kërkësë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë."), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit

